

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-94/13

Prishtinë,  
20 dhjetor 2014

Në çështjen juridike të:

**D.A.**

Serbi

**Paraqitësia e ankesës**

**kundër.**

**Sh. K.**

Obiliq

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Gjyqtarët: Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/167/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA23361), i datës 05 shtator 2012, pas seancës gjyqësore të mbajtur me 20 nëntor 2014, mori këtë:

## AKTGJYKIM

Hedhet si e pasafatshme ankesa e D.A. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/167/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA23361), i datës 5 shtator 2012.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 23 korrik 2007, D.A. ka depozituar një kërkesë në AKP të regjistruar në nr. KPA23361 në cilësinë e titullarit të së drejtës së shfrytëzimit të shtëpisë që gjendet në ngastër kadastrale 554 në fshatin Miloshevë, Obiliq duke kërkuar të drejtën e ri posedimit. Këtë shtëpi e ka ndërtuar në vitin 1990. Ngastrën ku e ka ndërtua shtëpinë ia ka ndarë Shkolla Fillore në Miloshevë ku ka punuar. Në vitin 2000 e njëjta shtëpi është djegur dhe se më vonë sërish është rindërtuar ku me ç ‘rast janë vendosur disa shqiptarë.

2. Për ta mbwshtetur kwrkeswn e saj, ajo ka paraqitur nw AKP dokumentet si nw vijim:

- Letërnjoftimin të lëshuar me datë 24 mars 2011.
- Kërkesën e dt.20 gusht 1990 drejtuar Shkollës Fillore në Miloshevë për t’ia lejuar asaj të drejtën për vendosjen e objektit montazhe.
- Fletën poseduese i dt.20 gusht 1990,e Drejtorisë për Gjeodezi, me të cilën konstatohet se ngastra 554 në vendin e quajtur “Vishe Sela” zona kadastrale Miloshevë, është në pronësi shoqërore të cilën e shfrytëzon Shkolla Fillore në Miloshevë.

3. Ekipi i verifikimit i AKP-së sipas raportit të verifikimit të datës 17 janar 2008 dhe 10 shkurt 2010, ka konstatuar që sipas fletës poseduese të theksuar prona e kërkuar është regjistruar në emër shkollës fillore në Miloshevë. Ndërkaq, kjo pronë e paluajtshme me vendimin e Kuvendit të Komunës së Obiliqit i dt. 26 maj 2009, i është ndarë në shfrytëzim Sh.K. dhe me dt.20 qershor 2009, B.Sh.

4. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e saj KPCC 167/2012 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 23361 i datës 05 shtator 2012, të refuzohet, me arsyetim se paraqitësi i kërkesave ka dështuar të paraqes dëshmi të mjaftueshme për të dëshmuar të drejtën e shfrytëzimit.

5. A. D. në cilësinë e ankueses vendimin ankimor e ka pranuar më 04 mars 2013, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 05 prill 2013

**Pretendimet e palws ankuese:**

6. Paraqitësja e ankesës pretendon se vendimi ankimor nuk përfshinë arsyetime të drejtave të ligjshme. Kjo për arsye se , komisioni ia kufizon të drejtë e shfrytëzimit të banesës duke propozuar anulimin e atij vendimi.

**Arsyetimi ligjor:**

**Pranueshmëria e ankesave:**

7. Gjykata Supreme pas shqyrtimit dhe vlerësimit të vendimit ankimor dhe ankesave të paraqitura sipas nenit 194 të LPK-së gjeti se ankesa është e pasafatshme.

8. Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi ankesën e ankueses si të pasafatshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së. Kjo ngase, se A. D. në cilësinë e ankueses vendimin ankimor e ka pranuar më 04 mars 2013, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 05 prill 2013. Nga kjo mund të konstatohet se ankuesja ankesën e ka paraqitur pas afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

10. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 ,duke hedhur ankesën si të pasafatshme, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore:**

Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**